

REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2807/4 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

VENDIM
Nr. 48, datë 26.11.2025

**PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË MASTER
EKZEKUTIV NË “MENAXHIM FARMACEUTIK DHE INOVACION”, PRANË
FAKULTETIT TË MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 4, shkronja “c”, neni 35, neni 49, pika 1, a), neni 77, pikat 1 dhe 2, Statutin e UMT-së neni 51, pika 1, a) dhe 98, pika 4 Rregulloren e UMT-së, Udhëzimin e MAS nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, kreu IV, si dhe në Vendimin nr. 131, datë 21.11.2025 “Për miratimin e hapjes së programit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në “Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion”, në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë”, të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 26.11.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të tretë Master Ekzekutiv në “Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion”, pranë Fakultetit të Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.
2. Burimi i financimit për programin e ciklit të tretë të studimit Master Ekzekutiv në “Menaxhim Farmaceutik dhe Inovacion”, do të jetë nga të ardhurat që do të mbliidhen nga tarifa e shkollimit, pa efekte financiare shtesë nga buxheti i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Rektori dhe Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI
VANGJUSH STAVRO

ANËTARË

VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ